

V E N D I M
Nr.668, datë 7.12.2001

**PËR PJESËMARRJEN E SEKTORIT PRIVAT, ME KONTRATË KONCESIONI, NË
SHOQËRITË ANONIME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE TË BASHKIVE TË BERATIT
DHE TË KUÇOVËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.8103, datë 28.3.1996 "Për privatizimin e ndërmarrjeve të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura" dhe të nenit 5 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies me kontratë koncesioni, të formës BOT, të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a. të Bashkive të Beratit dhe të Kuçovës.
 2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit janë organet shtetërore, të autorizuar për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit.
 3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit që, në bashkëpunim me këshilltarin ndërkombëtar, të përgatisin kontratën e koncesionit, aktet nënligjore dhe dokumentet përkatëse për për zgjedhjen e operatorit privat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta